



Për: Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

Nga: Veton Berisha kryetar i Partia Liberale Egjiptiane – PLE

Lënda: Kërkesë për rishikimin e vendimit të PZAP-së, Anr. 624/2021 i datës 18.10.2021

21 tetor 2021

KËRKESË

për rishikimin e vendimit të PZAP-së

Bazuar në Nenin 118 pika 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme KËRKOJË nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) të e rishikoj vendimin Anr.624/2021 i datës 18.10.2021 me ç'rast më është shqiptuar edhe gjobë prej 300 EUR! Unë jam i bindur se video e publikuar në profilin tim në Facebook fare nuk kishte të bënte me ndikim potencial ndaj votuesve, por publikimi i asaj video kishte qëllim kryekëput humanitar më qëllim të mirë që të ndihmoj përfundimin e 37 shtëpive për familjet më nevojë të nisura në vitin 2019 dhe besoj se nuk kam vepruar fare në kundërshtim me Nenin 8 të Rregullores Zgjedhore nr.13/2013, pra nuk e kam thyer heshtjen zgjedhore!

Arsyetim

- Në video publikuar me datës 16.10.2021 në profilin tim në facebook në të cilën pala ankuese IRDK ju ka referuar se unë kam thyer heshtjen zgjedhore dhe po ashtu vendimi i PZAP-së Anr.624/2021 tek paragrafët e fakteve të bazuara është thënë **se unë kinse kam bërë thirrje të votohet subjekti im politik në këtë rast Partia Liberale Egjiptiane (PLE)-ja dhe të mos votohet IRDK-ja!** Ju konfirmoj me përgjegjësi të plotë penale dhe morale se në asnjë moment në atë video nuk e kam bërë një gjë të tillë! Me këtë rast ju ftoj me kujdes të veçantë të e shikoni edhe njëherë videon origjinale të deponuar bashkë me këtë shkresë dhe po ashtu mund të i referoheni videos e cila akoma është publike në profilin tim në facebook¹!
- Video e cila është e deponuar nga ana e ankuesit (IRDK-së) me anë të CD-së një kopje të së cilës ju si PZAP më keni dorëzuar edhe mua e njëjta ju konfirmoj se ka defekte në

¹ Video në profilin tim: <https://www.facebook.com/728411281/videos/267941055219440/>

audio dhe deklarimi im në atë video dëgjohe shumë dobët dhe me shumë ndërprerje të zërit dhe konsideroj se ju si anëtar të PZAP-së keni rënë në lajthim nga ana e palës ankuese nga një CD me defekte në pamje dhe nga zëri!

- Konstatimi nga ana e PZAP-së se unë si kryetar PLE-së jam kundërshtar politik i IRDK-së konsideroj se është i pa bazuar për faktin se unë nuk kam qenë fare në garë si kandidat e po ashtu siç e dini zgjedhjet e 17 tetorit kanë qenë zgjedhje lokale dhe ju konfirmoj me përgjegjësi të plotë penale dhe morale se në asnjë komunë të Kosovës nuk kemi qenë në garë me partinë e IRDK-së për të u konsideruar si kundërshtar! Ne si PLE kemi qenë në garë vetëm në komunën e Pejës në të cilën komunë nuk kanë qenë në garë IRDK-ja dhe IRDK-ja ka qenë në garë në Gjakovë dhe Istog në komuna këto në të cilat ne si PLE nuk kemi qenë në garë! Pra nuk kam pasur as nevojë dhe as arsye të kundër lobj sepse nuk kemi pasur interes elektorale.
- Vendimi i PZAP-së po ashtu është i bazuar edhe në shumën e fondeve që ne si Subjekt Politik kemi marrur nga buxheti i Kosovës për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore! Ju bëjmë me dije se ne si PLE që nga 14 shkurti 2021 nga zgjedhjet parlamentare ma nuk jemi pjese e parlamentit të Kosovës, rrjedhimisht nga ajo kohë nuk marrim fonde nga buxheti i Kosovës.
- Arsyet kryesore pse kam dal me atë video ka qenë se unë po në të njëjtën ditë kam pranuar thirrje nga tri familje të cilat janë në proces të ndërtimit të shtëpive me ç'rast më është bërë presion i madh që të përfundojnë ato shtëpi! Unë duke qenë shumë i bindur se përfundimi i shtëpive të mbetura në gjysmë është në mundësit e ministrit Elbert Krasniqit dhe deputetit Fridon Lala që përmes tyre të kërkojnë nga kryeministri Kurti që të ndaj urgjent fond për përfundimin e shtëpive! Këtë angazhim që të shtyjej procesin e ndërtimit e kam tani e tetë muaj duke tentuar të përfundojnë para stinës së dimrit, pra qëllimi ka qenë humanitar dhe asesi ndikues në votuesit për zgjedhjet lokale sepse subjektet të cilave ju kam drejtuar kanë qenë persona publik të nivelit qendror!

Të nderuar anëtar të PZAP-së duke ju referuar edhe Nenin 118 pika 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme duke ju lutur për mirëkuptimin tuaj dhe duke besuar në profesionalizmin tuaj, kërkoj nga ju të e rishqyrtoni vendimin tuaj fillimisht duke e shiqur dhe degjuar me kujdes videon e ankimit nga ana e IRDK-se dhe me pas edhe faktet tjera!

Me respekt

Veton Berisha

Kryetar i Partisë Liberale Egjiptiane



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.624/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Kymete Kicaj dhe Afijete Sada - Glllogjani anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Iniciativca e Re Demokratike e Kosovës – (IRDK), të paraqitur kundër subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane – (PLE), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 18.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e Anr.624/2021, e datës 17.10.2021 e paraqitur nga subjekti politik, Iniciativca e Re Demokratike e Kosovës – (IRDK), ndërsa supejtkit politik Subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane – (PLE) i shqiptohet gjobë, në lartësi prej 300.00 euro (treqind), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për zgjedhjet lokale të datës 17.10.2021.

II. DETYROHET Subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane – (PLE), që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Me datë 17.10.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.624/2021, e paraqitur nga subjekti politik Iniciativca e Re Demokratike e Kosovës – (IRDK), kundër subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane – (PLE), në të cilat pretendon se kryetari i PLE-së, Veton Berisha me datë 16.10.2021, në ora 1:24 PM, rreth 18 orë para hapjes së vendvotimit përmes një video publike në rrjetin social facebook, nga llogaria e tij i është drejtuar publikut me qëllim të ndikimit të votuesit potencial të kandidatit Fridon Lala dhe të gjithë kandidatëve të tjerë nga subjekti politik IRDK, duke vepruar në kundërshtim me nenin 8 të Rregullës Zgjedhore nr.13/2013. Gjithashtu ka theksuar se i njejtë ka bërë akuza krejt paushalle për Fridon Lala i cili është edhe zëvendës kryetar i IRDK-së dhe deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, dhe duke mos pasur mundësi që Fridon Lala të mos demantoj për shkak të heshtjes zgjedhore. Kandidati Fridon Lala dhe të gjithë kandidatët e IRDK-së në komunën e Gjakovës dhe komunës së Istogut janë dëmtuar qëllimisht nga kryetari i PLE-së. duke u bazuar në provat që i kemi jemi të sigurt se kryetari u PLE-së, Veton Berisha ka bërë veprime në kundërshtim me nenin 8 pikës (c). të rregullës zgjedhore nr.13/2013.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane – (PLE), me të cilën pretendon se: video publikimi i datës 16. Tetor 2021, drejtuar ministrit Elbert Krasniqi

dhe deputetit të Kuvendit të Kosovës, Fridon Lala nuk kishte të bënte fare me zgjedhjet lokale të datës 17.10.2021, dhe ndikimit në të, por kishte të bënte me lutje publike për një proces të ndjeshëm të pengimit të procesit përfundimit të ndërtimit nga ana e të lartpërmendurve të 37 shtëpive, të dedikuar për familjet në gjendje të rëndë ekonomike të komunitetit Egjiptian, e të cilat ishin nisur gjatë viteve 2018 – 2019, ku me iniciativën time ishin nisur të ndërtohen. Këso lloj reagimesh kam pasur gjatë gjithë kohës tani e 8 muaj prej që unë jam pjesë e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Reagimi im publik përmes rrjetit social facebook edhe duke iu lutur edhe duke ju bërë kërkesë publike që të mos pengojnë më tepër këtë procesë, vie si rrjedhojë e kërkesës dhe presionit ndaj meje për shkak se ndërtimit i atyre shtëpive është ndërpre. Gjithashtu thekson se ankesa nuk ka për ndëshkim nga PZAP, sepse nuk ka prova që dëshmojnë se ka thirrje për votim.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale audio -video, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës shihet se subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane – (PLE) konkretisht kryetari i këtij subjekti Veton Berisha, gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin e saj social facebook përmes audio – video, ka bërë fushatë zgjedhore duke akuzuar kundërshtarin politik nga subjekti Iniciativca e Re Demokratike e Kosovës – (IRDK), dhe njëkohësisht duke bërë thirrje që të votohet subjekti i tij politik (PLE), e që me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës, dhe gjeti se të njëjtat pretendime janë të bazuara, për faktin se në llogarinë e Facebook-ut, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës, në ditën e heshtjes zgjedhore kryetari i subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane – (PLE), me datë 16.10.2021, në ora 13:24, ka publikuar nje audio – video, duke bërë thirrje që të votohet subjekti i tij politik dhe duke akuzuar kundërshtarët e tij politik nga subjekti politik Iniciativca e Re Demokratike e Kosovës – (IRDK), dhe në këtë mënyrë ka thyer heshtjen zgjedhore.

Paneli me rastin vendosjes mori parasysh kundërshtimet e subjektit politik PLE, por të njëjtat ishin pa ndikim për te vendosur ndryshe në këtë rast.

Andaj Paneli, duke iu referuar të cekurave më lart dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane -- (PLE), është përgjegjëse për veprimet e tija, pasi që me veprimet e lartcekura ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton se: *“ veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre ”.*

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë: natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoba, ka marrë pjesë në zgjedhjet

e mëparshme, shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, vlerëson se gjoha e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet klimë e qetë dhe e përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekuar në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.624/2021 më datë 18.10.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.